



UNIVERSITETI - UNIVERSITETI
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti Ekonomik

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI

Pranuar me dt. 06.11.2023			
Njesia orga	Num	Nr. Ekzem	Vlera
	25862		

Nr. Prot. 314/2 Dt. 03.11.2023

Në mbështetje të nenit 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 1670 dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, Këshilli i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen mbajtur më 02.11.2023, pas shqyrtimit morri

Vendim

1. Aprovohet Raporti i Komisionit vlerësues për pozitën e shpallur në konkursin për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm: **Një mësimdhënës për lëndën: Menaxhimi i resurseve humane.**
2. Raporti i Komisionit vlerësues është i kompletuar dhe i përcjelllet Zyrës për çështje akademike të UIBM, për publikim në ueb faqen e UIBM, sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM.
3. Këshilli i Fakultetit propozon që kandidat-i/ja Dr. sc. Afërdita Shabani të angazhohet bashkëpunëtor i jashtëm – mësimdhënës për mbajtjen e ligjëratave për lëndën Menaxhimi i resurseve humane.
4. Pjesë e këtij vendimi është Raporti i Komisionit vlerësues.

Vendimi i dërgohet:

- Dekanit;
- Zyrës për çështje akademike;
- Sekretarit të Fakultetit;
- Arkivit.

Prof. asoc. dr. Qazim Tmava

Dekan



Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/515516 – lokali 6

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

Raporti i Komisionit vlerësues sipas Konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2023/2024, me numër 2067 të datës 10.10.2023



UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES

Fakulteti	Ekonomik
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	Menaxhimi i resurseve humane
Kandidatët e paraqitur:	1. Dr. Sc. Aferdita SHABANI

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar	Prof. Asoc. Dr. Bashkim BELLAQA
2. Anëtar	Prof. Asoc. Dr. Qazim TMAVA
3. Anëtar	Prof. Asoc. Dr. Esat DURGURTI

Shënimet për kandidatin/en për të cilin/en shkruhet raporti**Kandidati/ja 1**

Emri dhe mbiemri	<i>Afërdita SHABANI</i>
Datëlindja dhe vendlindja	<i>25.05.1971</i>
Grada shkencore	<i>Dr.sc</i>
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje)	
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	
Universiteti/fakulteti/departamenti	

Sqarim: Kandidatet të cilët krahas gradës doktor i shkencave kanë edhe titullin akademik të ligjëruesit ose profesorit, të fituar në UP, kanë përparësi në përzgjedhje.

Arsimimi i lartë	
Studimet e doktoratës-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i doktorimit, (nostrifikimi nëse kandidati ka studiuar jashtë vendit)	<i>Universiteti "SV Kliment Ohridski" Bitola - Fakulteti Ekonomik Titulli: Doktor i ekonomisë në biznes ndërkombëtar – (Dr.Sc). Data e doktorimit: 11.11.2021. Nostrifikim: Vendimi i MASHTI – datë 27.02.2023 me numer prot. 2/6/980.</i>
Studimet master/Magjistraturë, Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare (nostrifikimi nëse kandidati ka studiuar jashtë vendit)	<i>Kolegji i Menaxhmentit Internacional 'Globus' - Fakulteti Ekonomik, Titulli: Master në programin Menaxhment Gjeneral Internacional (MA). Data e diplomimit: 15.04.2012. Nota mesatare: 8.33</i>
Studimet themelore-Universiteti, Fakulteti, departamenti, titulli i fituar, viti i diplomimit, nota mesatare (nostrifikimi nëse kandidati ka studiuar jashtë vendit)	<i>Universiteti i Prishtinës - Fakulteti Ekonomik Titulli: Ekonomist i diplomuar - (Ecc.dpl), Departamenti: Ekonomia e Ndërmarrjes Data e diplomimit: 02.06. 1995. Nota mesatare: 7.40</i>

Sqarim: Në këtë tabelë paraqitën shënimet për secilin kandidatë që i shkruhet raporti. Të shtohen tabela, varësisht nga numri i kandidatëve.

1.Përmbledhje e aktivitetit shkencor të kandidatit

Tabela I: Punimet e publikuara pas thirrjes se fundit në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 01/2018 PARIMET E NJOHJES SË PLATFORMAVE DHE REVISTAVE NDËRKOMBËTARE ME RECENSION dhe Udhëzimit Administrativ për PLOTËSIMIN DHE PRECIZIMIN – (ANEKS – I – MASHT) Nr. 7/2018 e UA Nr. 01/2018 PARIMET E NJOHJES SË PLATFORMAVE DHE REVISTAVE NDËRKOMBËTARE ME RECENSION si dhe Rregullores së UMIB, numër protokollit 1201, datë 11.09.2018 dhe rregullores 1667 datë 28.09.2021

Nr	Autori/ët	Titulli i punimit	Platforma	Koeficienti i Revistës (indeksim)	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues ¹
1	Shabani, H., Mehmetaj, A., Ahmeti, B., &	The Effects of Lack of Competition Control in Kosovo's Economy Case study: Insurance Industry (Creation of Cartels).			International Journal of Current Engineering and Technology	7 (3), 14 June 2017.	http://inpressco.com/category/ijcet

¹ Komisioni vlerësues është i obliguar të shënojë linkun nëpërmjet të të cilit dëshmohet indeksimi i punimit përkatësisht revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse

	Shabani, A.						
2	Aferdita Shabani Halit Shabani	INFLUENCE OF THE INTERNATIONAL MONETARY FUND AND GLOBALIZATION ANALYSIS OF THE CASE OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA			KNOWLEDGE - International Journal	16(4), pp. 1413-1422. (2023)	https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/4422
3	Shabani, H., Shabani, A., & Elezaj, E.	Strategic Alliances and Changes in the Competition Environment.			Int. J. Pharm. Sci. Rev.	45(2), pp. 272-277 (2017)	https://globalresearchonline.net/journalcontents/v45-2/48.pdf
4	Shabani, Halit and Shabani, Aferdita	Pharmaceutical competitiveness and impact on the health of the population in Kosovo 2010-2017	Scopus		Journal of Pharmaceutical Sciences and Research.	Vol. 10 (3), 2018, 509-510	https://www.jpsr.pharmainfo.in/Documents/Volumes/vol10Issue03/jpsr10031816.pdf

Në këtë tabelë duhet të radhiten vetëm punimet që i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Statutin e UIBM-së dhe Rregulloren e UMIB-it me numër protokoll 1201, datë 11.09.2018 dhe Rregullores 1667 nga data e miratimit 28.09.2021. Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave për punimet e radhitura në këtë tabelë.

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën I.

(Komisioni vlerësues duhet të ofrojë informata për tipin e publikimeve, për revistën në të cilën ka botuar autori duke iu referuar statusit të kandidatit/les në kuadër të punimit (p.sh. autor i parë etj), "impakt faktorin" e revistës, shtëpinë botuese, ORCID ID etj. Komisioni duhet të precizojë burimin e informatave në të cilin është mbështetur dhe i cili mund të verifikohet. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Kandidatja, Aferdita SHABANI, ka publikuar gjithsej 4 publikime, dhe atë një (1) punim si autore e parë, dy si autore e dytë (2), dhe një si bashkautorë. Publikimet shkencore të publikuara nuk janë në platformat e specifikuara sipas Rregullores për procedurat dhe kriteret e Zgjedhjes, Rizgjedhjes dhe Avancimit të Personelit Akademik të datës 28.09.2021 me nr. protokoll Nr. 1670, nenit 7, pika 2.2 të Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, si dhe vendimit të AKA-së me datë: 21/09/2021 me nr të referencës: 32326/21D.

Punimi i publikuara si autore e dytë:

1. Journal of Pharmaceutical Sciences and Research, punimi i publikuar është: Pharmaceutical competitiveness and impact on the health of the population in Kosovo 2010-2017. Revista është e indeksuar në platformën: SCOPUS, mirëpo gjatë verifikimit në bazën e të dhënave në SCOPUS, figuron shënime se revista ishte e indeksuar nga periudha 2010 deri më 2016. Ndërsa punimi është publikuar në vitin 2017. Emri i autores figuron në bazën e të dhënave të SCOPUS-it. Punimi gjithashtu, vlen të nënvizohet nuk është në kuadër të fushës së doktoratës si dhe me lëndën e shpallur në konkurs.

Punimet tjera:

2. Ka të publikuar edhe tri (2) punime shkencore në platformat të cilat janë të përfshira në Scopus dhe Web of Science.

Tabela II. Mentorimi

Emri Mbiemri (i kandidatit/es)	Diploma/ Niveli i studimit	Data e regjistrimit/ lejimit të punimit	Në proces	Data e përfundimit

Sqarim: Plotësohet tabela me emrat e kandidatëve të cilët i ka mentoruar pas thirrjes së fundit.

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

(Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit/es, universitetet ku ai/ajo ka punuar, programet akademike, kualifikimet, angazhimi në institucione jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura, duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Kandidatja, bazuar në dokumentacionin e ofruar dëshmon se nuk disponon ndonjë përvojë në procesin e mësimdhënies direkte, mirëpo vërehet se ka mbajtur disa leksione dhe trajnime për stafin e Administratës Tatimore të Kosovës.

Tabela III. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave etj.

Nr	Autori/ët	Titulli i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti	Numri i ISBN

Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi lidhur me saktësinë e informatave të radhitura në tabelën III.

Tabela IV. Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, nivel ndërkombëtar dhe vendore

Nr	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi, vëllimi, nr., faqet, viti etj.	Certifikata e prezantimit ose agenda
			Participation in Conference -4th International Scientific Conference of the Faculties of Economics & Business Administration – University of Tetova Faculty of Business – UNIVERSITY HAXHI ZEKA, ISCFE 2016-02.12.2016 Tetova, Macedonia	
			Participation in Conference -1st International Scientific Conference on Business And Economics – Building Bridges Between Business Research and Industry Needs ; 17-18 February , South East European University, 2017 Tetovo, Republic of Macedonia	
			Participation in Conference -5th International Scientific Conference “Challenges of Doing Business in the Contemporary World”- University of Tetova – Faculty of Economics and Faculty of Business Administration	
			Participation in Conference –“Conditions and Perspectives of Tourism, Economy and	

			Business Logistics"- University "Goce Delce " STIP, Faculty of Tourism and Business Logistics	
			Participation in Conference –XI-th International Conference "Strategy for Economic and Local Economic Development of Municipalities in Balkan Countries with Special Provisions the Observations, Challenges and Opportunities for the Development. ; 04-05 Aprill 2019 Ulcinj, Montenegro	
			Participation in Conference- Twelfth International Scientific Conference , Knowledge Without Borders with: Fondi Monetar nderkombetar dhe Globalizimi/ analiza ne Republiken e Maqedonise; 32 Mars-02 Prill 2017	

- **Sqarim:** Kandidatja konferencat e cekura më sipër janë të siguruar nga CV e kandidatës, mirëpo e njëjta nuk ka ofruar dëshmi (certifikatë, libër të konferencës apo libër te abstraktit).

Tabela V. Ligjëratat-prezantimet, ligjërues i ftuar në universitet dhe punëtori shkencore nga lëmi i kandidatit

Nr	Autorët (renditja si në Ligjërata/Prezantim)	Titulli i ligjëratis	Lloji i ligjëratis (Universitet, Punëtori Shkencore)	Viti, Vendi

Tabela VI. Redaktor/Recensent në revistat akademike apo shkencore

Nr	Kontributi (redaktor/recensent)	Autori/ët e punimit	Titulli i punimit të recensuar	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recension	Vendi, Viti

3. Përvoja menaxhuese, angazhimet profesionale dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitivet dhe funksionet udhëheqëse, projektet shkencore dhe projektet e tjera në të cilat ka marrë pjesë kandidati, statusi i tij në projekt, programi prej të cilit është financuar projekti, çmimet dhe mirënjohjet, kualifikimet e ndryshme, patentat, inovacioni etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

- Kandidatja Afërdita SHABANI, ka eksperiencë afro 16 vite në Administratën Tatimore të Kosovës. Që nga viti 2007 e deri me tani punon pranë Administratës Tatimore të Kosovës. Eksperiencën në fillim e ka filluar në cilësinë e inspektorit tatimor, pastaj inspektore e arsimit tatimor, këshilltar tatimor, drejtuese e divizionit të shërbimeve tatimore, menaxhere e lartë e projekteve për projekte ndërkombëtare si dhe nga data 25.10.2023 e deri më tani punon në cilësinë e Drejtoreshës në Departamentin e Shërbimeve Tatimore dhe Regjistrimit.
- Ka marrë pjesë në gjashtë konferenca shkencore.
- Ka ndjekur seminare brenda dhe jashta vendit në fushën e tatimeve si dhe në fushën e komunikimit

4. Mobiliteti i kandidatit/es

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ai ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore, qëndrime: hulumtuuese jashtë vendit etj. Argumentet relevante për të dhënat dhe burimet mbështetëse për të dhënat e paraqitura duhet të bashkëngjiten në këtë raport).

Kandidatja Afërdita SHABANI, Fakultetin Ekonomi 4 vjeçar e ka të përfunduar në kuadër të Universitetit të Prishtinës, në drejtimin: Ekonomia e Ndërmarrjes. Më pastaj, studimet Master ka të përfunduara në kuadër të Kolegjit për Menaxhment Internacional – Globus në programin: Menaxhment Gjeneral Internacional. Ndërsa, studimet e doktoratës i ka përfunduar në Universiteti "SV Kliment Ohridski" Bitola - Fakulteti Ekonomik Titulli: Doktor i ekonomisë në biznes ndërkombëtar.

Përfundimi dhe propozimi

(Anëtarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsytim të shkurtër për kandidatin të cili propozohet si bashkëpunëtorë i jashtëm. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre vetëm për një kandidat për një pozitë (ose për më tepër kandidatë, nëse ashtu është kërkuar me konkurs). Komisioni vlerësues përmbledh të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar dhe sjell konkludimin dhe propozimin e arsytuar për kandidatin dhe titullin në të cilin propozohet (sipas kërkesave të konkursit, Statutit dhe pozitës së shpallur) për kandidatin i cili propozohet për pozitën e shpallur. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatet, ndërsa 4 kapitujt paraprake shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).

Komisioni recensues i formuar me Vendimin me numër protokoli 282 të Këshillit të Fakultetit Ekonomik të datës 17.10.2023 të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, duke u bazuar në Statutin e UIBM, Rregulloren për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, me nr. prot. 1670 të datës 28.9.2021 si dhe konkursin publik të datës 10.10.2023, nr.prot. 2067, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve, konstaton:

Kandidatja, Afërdita SHABANI, i plotëson kushtet formale të konkursit në përjashtim të pikës 2.2 të nenit 7 të Rregullosës për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM për një mësimdhënës nga lënda Menaxhimi i resurseve humane. Këtë konstatim komisioni vlerësues duke u bazuar edhe në disa çështje si në vijim: mos aplikimi i kandidatëve tjerë, dhe domosdoshmëria e angazhimit të një mësimdhënësi për lëndën e shpallur në konkurs. Duke analizuar të gjitha këto rrethana komisioni vlerësues nxjerrë këtë:

Propozim


Komisioni recensues i propozon këshillit të fakultetit ekonomik që: Kandidatja, Afërdita SHABANI, të angazhohet në pozitën e mësimdhënësit në lëndën Menaxhimi i resurseve humane në Fakultetin Ekonomik, pranë Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë. Ky propozim bëhet duke u bazuar në faktin se kandidatja Afërdita SHABANI, i plotëson disa nga kushtet formale të parapara për këtë pozitë, sipas konkursit publik të datës 10.10.2023, nr. prot. 2067, pika V , numer 1, sipas Statutit të UIBM, si dhe Rregullosës për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, me nr. Protokoli 1670, datë 28. 09. 2021, i plotëson pikat 2.1 të nenit 7.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:
[të shënohet thirrja e saktë akademike]

1. Prof. Asoc. Dr. Bashkim BELLAQA, Kryetar _____



2. Prof. Asoc. Dr. Qazim TMAVA, Anëtar _____



3. Prof. Asoc. Dr. Esat DURGUTI, Anëtar _____



Datë: 30.10. 2023

